

[Type text]

## Opinion 2/19

*në pajtim me Nenin 3 (1) të Rregullores (KE) Nr. 714/2009 dhe Nenin 10 (6) të Direktivës 2009/72/EC-Kosovo\*<sup>1</sup>- Certifikimi i KOSTT-it*

Më 2 tetor 2018, Zyra e Rregullatorit për Energji e Kosovës\* (në tekstin e mëtejshëm: ZRRE) njoftoi Sekretariatit për Vendimin Preliminar për Certifikimin e Sistemit Operativ të Transmisionit dhe Tregut - KOSTT SH.A. (në tekstin e mëtejshëm "KOSTT"), Operatori i Sistemit të Transmisionit (në tekstin e mëtejshëm "OST") për energjinë elektrike (në tekstin e mëtejshëm "Vendimi Preliminar"). Vendimi Preliminar u miratua më 24 shtator 2018<sup>2</sup> në bazë të Ligjit nr. 05 /L-084 për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Energjinë Elektrike) dhe Ligji Nr. 05/L-081 Energjisë, si dhe Rregulloren Nr. 14/2017 për Certifikimin e Operatorëve të Sistemit të Transmisionit të miratuar nga ZRRE, më 13.04.2017.

Në përputhje me Nenin 10 të Direktivës 2009/72/EC<sup>3</sup> (në tekstin e mëtejshëm: Direktiva e Energjisë Elektrike) dhe Nenin 3 të Rregullores (EC) Nr. 714/2009<sup>4</sup> (në tekstin e mëtejshëm "Rregullorja e Energjisë Elektrike") Sekretariatit i kërkohet të shqyrtojë Vendimin Preliminar dhe t'i dërgoj mendimin e tij ZRRE-së për sa i përket pajtueshmërisë së një vendimi të tillë me nenin 10 (2) dhe nenin 9 të Direktivës së Energjisë Elektrike.

Më 24 janar 2019, Sekretariati mori një Opinion mbi Vendimin Preliminar nga Bordi Rregullativ i Komunitetit të Energjisë (në tekstin e mëtejshëm "ECRB"), siç kërkohet në pajtim me Nenin 3 (1) të Rregullores së Energjisë Elektrike.

### I. Roli i Shtetit në ndërmarrjet e Energjisë në Kosovë\*

#### 1. Aplikuesi KOSTT

Bazuar në nenin 12 të Ligjit Nr. 2004/10 për Energjinë Elektrike, nga 29 prill 2004, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit<sup>5</sup> miratoi një vendim për ndarjen e ndërmarrjes së integruar vertikalisht Korporata Energjetike e Kosovës në dy ndërmarrje të ndara: "Korporata Energjetike e Kosovës" SH.A. (në tekstin e mëtejshëm KEK Holding) dhe "Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut Holding" SH.A. (në tekstin e mëtejshëm KOSTT Holding).

<sup>1</sup> Ky përcaktim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me UNSCR 1244/1999 dhe Opininion Këshillëdhënës të ICJ mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

<sup>2</sup> ZRRE, Vendimi Preliminar, Nr. V\_1033\_2018, i miratuar më 24.09.2018.

<sup>3</sup> Direktiva 2009/72 / KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 korrik 2009 lidhur me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike dhe shfuqizimin e Direktivës 2003/54 / EC, të përfshirë dhe përshtatur me Vendimin 2011/02 / MC-EnC të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë të datës 6 tetor 2011.

<sup>4</sup> Rregullorja (KE) Nr. 714/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 korrik 2009 mbi kushtet për qasje në rrjetin për shkëmbimet ndërkufitare të energjisë elektrike dhe shfuqizimin e Rregullores (EC) Nr 1228/2003, të përfshirë dhe përshtatur me Vendimin 2011/02 / MC-EnC të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë të datës 6 tetor 2011.

<sup>5</sup> Themeluar në vitin 2002 me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/12 për menaxhimin e ndërmarrjeve publike. Shih: ZRRE, Vendimi Preliminar, par. 8.

[Type text]

E para ka kryer aktivitetet e minierave, të linjitet dhe të prodhimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike, dhe kjo e fundit ka kryer sistemin e transmisionit të energjisë elektrike dhe aktivitetet e operatorit të tregut. Më 22 dhjetor 2005, Asambleja e Përgjithshme e KOSTT Holding themeloi KOSTT SH.A. si një vartës dhe transferoi në KOSTT Sh.A. 100% të aseteve për kryerjen e funksioneve të Operatorit të Transmisionit dhe Tregut në Kosovë<sup>6</sup>. KOSTT u regjistrua më 23 dhjetor 2005 si Shoqëri Aksionare<sup>7</sup> dhe u licencua për herë të parë nga ZRRE në vitin 2006, për aktivitetet<sup>8</sup> e transmetimit të energjisë elektrike dhe të tregut.

KOSTT është në pronësi të plotë publike dhe ka organet e mëposhtme korporative:

- Kuvendi i Përgjithshëm me kompetencë për të: ndryshuar statutin dhe aktet nënligjore të ndërmarrjes; të vendosë për unifikimin, konsolidimin, ndarjen, shpërndarjen, likuidimin, transformimin; ose falimentimin; rritjen ose uljen e kapitalit aksionar; të vendosë për lëshimin e aksioneve, borxheve ose sigurimeve të konvertuara në aksione, si dhe konsolidimin ose ndarjen e aksioneve të papaguara dhe konvertimin e sigurimeve; emëron (me propozimin e një komiteti të auditimit), heq ose zëvendëson auditorët e jashtëm etj.<sup>9</sup> Të drejtat e aksionarëve në Kuvendin e Përgjithshëm ushtrohen nga Kuvendi i Kosovës, \* i përfaqësuar nga një person, përfaqësuar nga Kryetari i Kuvendit.<sup>10</sup>
- Bordi i Drejtorëve, i përbërë nga shtatë anëtarë, njëri prej të cilëve është Kryetar. Sipas nenit 14 të Ligjit për Energjinë Elektrike, pesë nga anëtarët dhe Kryetari emërohen dhe shkarkohen nga Kuvendi i Kosovës, ndërsa Kryeshefi Ekzekutiv, si anëtar i Bordit të Drejtorëve, zgjidhet nga vetë Bordi i Drejtorëve. Në bazë të nenit 13 (4) të Ligjit për Energji Elektrike, kompetencat e Bordit janë të përcaktuara në Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe përfshijnë: miratimin e planeve strategjike të biznesit, kontrollin e brendshëm, auditimin, si dhe procedurat e administrimit të rrezikut; mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit, përgatitjet e rendit të ditës të Kuvendit, aprovimin e raportit vjetor, raportin e bilancit vjetor dhe vlerësimet vjetore të fitimeve dhe humbjeve për miratim nga Kuvendi i Përgjithshëm dhe vendimmarrjen për të gjitha çështjet tjera të përcaktuara në Statutin e KOSTT-it.<sup>11</sup> Sipas nenit 13 (5) të Ligjit për Energjinë Elektrike, Bordi i Drejtorëve është përgjegjës duke i raportuar Kuvendit të Kosovës \* së paku në baza vjetore<sup>12</sup>. Kryeshefi Ekzekutiv përfaqëson dhe menaxhon kompaninë.
- Komiteti i Auditimit emërohet poashtu nga Kuvendi i Kosovës \* sipas Ligjit për Energjinë Elektrike dhe përbëhet nga tre anëtarë të Bordit të Drejtorëve.<sup>13</sup> Kualifikimet e anëtarëve të Komitetit të

<sup>6</sup> Akti i transferimit në lidhje me transferimin e pronës së paluajtshme dhe linjave të energjisë elektrike të Sistemit të Transmisionit dhe Operatorit të Tregut Holding SH.A. tek Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut SH.A, të datës 22.12.2005.

<sup>7</sup> Numri i regjistrimit 70325350, regjistruar më 23.12.2005. Shoqëritë aksionere, KEK Holding Sh.A. dhe KOSTT Holding SH.A u likuiduan më 02.07.2010 dhe më 20.11.2009, respektivisht sipas Nenit 39 të Ligjit 03 / L-087 për Ndërmarrjet Publike.

<sup>8</sup> ZRRE, Regjistri i licencave nr. 13 (transmisioni) dhe 14 (operatori i tregut). Licencat për transmetimin e energjisë elektrike dhe operimin e tregut të energjisë elektrike janë lëshuar së pari më 04.10.2006 dhe janë ndryshuar më 18.07.2012 dhe 13.04.2017 - version i fundit (ZRRE / Li\_15 / 17) në dispozicion në: [http://www.kostt.com/website/images/stories/dokumente/tjera/licenca\\_me\\_pass/LICENCE\\_TRANSMISSION\\_SYSTEM\\_AND\\_MARKET\\_OPERATOR\\_J.S.C.pdf](http://www.kostt.com/website/images/stories/dokumente/tjera/licenca_me_pass/LICENCE_TRANSMISSION_SYSTEM_AND_MARKET_OPERATOR_J.S.C.pdf). Licencat janë të vlefshme deri më 04.10.2036. ZRRE lëshon licenca bazuar në Nenin 28 (2) të Ligjit të Rregullatorit në lidhje me Nenin 4 të Ligjit për Energjinë Elektrike; shih gjithashtu rregullat e Rregullatorit në lidhje me licencim ZRRE / Rregulli nr. 07/2017.

<sup>9</sup> ZRRE, Vendimi Preliminar, par.31.

<sup>10</sup> Neni 13 (2) dhe (3) i Ligjit për Energjinë Elektrike.

<sup>11</sup> ZRRE, Vendimi Preliminar, paragrafi 19.

<sup>12</sup> ZRRE, Vendimi Preliminar, par. 17, dhe në vijim.

<sup>13</sup> Neni 15 (1) i Ligjit për Energjinë Elektrike.

[Type text]

Auditimit dhe detyrat dhe përgjegjësitë<sup>14</sup> e tyre janë përcaktuar në Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (në tekstin e mëtejme: Ligji për Ndërmarrjet Publike).<sup>15</sup>

## 2. Aktivitetet publike të gjenerimit dhe furnizimit

Dy kompani të gjenerimit të energjisë elektrike, përkatësisht Korporata Energjetike e Kosovës SH.A (në tekstin e mëtejme "KEK"), kompani që operon dy termocentrale, përkatësisht "Kosova A"<sup>16</sup> dhe "Kosova B"<sup>17</sup> si dhe Hidroekonomia "Iber Lepenc" SH.A (në vijim "HC Ujmani")<sup>18</sup> janë 100% në pronësi publike.

Në bazë të nenit 5 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, Qeveria ushtron të drejtat e aksionarit në ndërmarrjet publike për prodhimin e energjisë elektrike. Kompetencat dhe detyrat ushtrohen nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik në emër të Qeverisë.

Pas privatizimit të Kompanisë Kosovare për Shprëndarje dhe Furnizim (në vijim "KEDS") në vitin 2013, Kosova\* ka shitur 100% të aksioneve të saj në KEDS tek ndërmarrja turke Calik Limak Energy SH.A<sup>19</sup>

Qeveria ose Kuvendi nuk ushtrojnë kontroll dhe nuk kanë ndonjë të drejtë tjetër në aktivitetet e furnizimit.

## **II. Vendimi Preliminar**

Neni 11 i Ligjit për Energjinë Elektrike, transpozon dispozitat për shturjen e pronësisë të nenit 9 të Direktivës së Energjisë Elektrike, duke përfshirë rregullat që kanë të bëjnë me shturjen e pronësisë së kompanive publike, në Nenin 9 (6) të Direktivës së Energjisë Elektrike.

Më 28 Prill 2017, KOSTT dorëzoi në ZRRE një aplikacion për Certifikim, në përputhje me modelin e shturjes. Pas vlerësimit të aplikacionit, ZRRE erdhi në përfundim se aplikacioni nuk ishte i kompletuar dhe kërkoi të dhëna shtesë nga KOSTT-i lidhur me dy rrethana të caktuara.<sup>20</sup> ZRRE pranoi aplikacionin e plotësuar më 5 korrik 2018. Pas kësaj date, ZRRE ka vlerësuar përputhshmërinë e KOSTT me kërkesat e shturjes pronësore të përcaktuara në Nenin 11 të Ligjit për Energjinë Elektrike si dhe me Rregullat e Certifikimit.

Më 24 shtator 2018, ZRRE-ja miratoi dhe më 2 tetor 2018 njoftoi Sekretariatit, rreth një Vendimi Preliminar për certifikimin e KOSTT-it, që është subjekt i Opinioneve të tanishëm të Sekretariatit. Në pjesën e tij operative, Vendimi Preliminar pa kushte e certifikon KOSTT-in në kuadër të modelit të shturjes pronësore.

<sup>14</sup> Neni 15 (2) dhe (3) i Ligjit për Energjinë Elektrike.

<sup>15</sup> Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i datës 13 qershor 2008, amandamentuar me Ligjin Nr. 04/L-111, të datës 20 prill 2012 dhe Ligjit Nr. 05/L-009, të datës 7 prill 2015.

<sup>16</sup> Licenca Nr. ZRRE / Li\_05 / 17\_A.

<sup>17</sup> Licenca ZRRE / Li\_05 / 17\_B.

<sup>18</sup> Licenca Nr. ZRR / 17/17.

<sup>19</sup> Vendimi Preliminar i ZRRE-së, par. 35, dhe në vijim.

<sup>20</sup> Shih Vendimin Preliminar të ZRRE-së, paragrafi 2-5.

[Type text]

### III. Vlerësimi i Vendimit Preliminar

#### 1. Të përgjithshme

Dispozitat e shturjes u hartuan për të ndarë kontrollin mbi operimin e Sistemit të Transmisionit nga njëra anë dhe aktivitetet e prodhimit dhe furnizimit si aktivitete konkurruese, në anën tjetër, me qëllim që të eliminohet një konflikt i mundshëm i interesit midis transmisionit dhe aktiviteteve të tjera të kryera nga ndërmarrjet e integruara vertikalisht.<sup>21</sup> Kjo objektivë përmbushet më së miri përmes zbatimit të modelit të shturjes së pronësisë, të nenit 9 të Direktivës së Energjisë Elektrike, të cilin Kosova e transpozoi në Ligjin e saj për Energjinë Elektrike të vitit 2016. Në një ambient tregu që ende mbizotëron në shumë Palë Kontraktuese përfshirë Kosovën\*, ku aktivitetet energjetike janë kryesisht të kryera nga ndërmarrjet publike dhe/ose të karakterizuara nga pozita dominuese në tregjet e tyre përkatëse, ndarja e kontrollit dhe parandalimi i konflikteve të interesit janë të një rëndësie të veçantë. Për këto raste, dmth. kur shteti si pronar angazhohet në më shumë se një aktivitet të lidhur me energjinë dhe prandaj duhet të konsiderohet një ndërmarrje e integruar vertikalisht brenda kuptimit të Ligjit Evropian për Energjinë<sup>22</sup>, Neni 9 (6) i Direktivës së Energjisë Elektrike ofron një variant të shturjes së pronësisë, një alternativë e ristrukturimit dhe privatizimit. Ndryshe nga rastet e shturjes së pronësisë sipas Nenit 9 (1) të Direktivës së Energjisë Elektrike, në situatat e përshkruara në Nenin 9 (6) lidhja e kontrollit brenda ndërmarrjes së integruar vertikalisht nuk është ndërprerë plotësisht. Ushtrimi i vazhdueshëm i pronësisë publike si dhe lidhjet kushtetuese dhe politike i bëjnë këto situata të dallojnë nga rastet e tjera të shturjes së pronësisë dhe ndikojnë në vlerësim. Duke u mbështetur në Nenin 9 (6), siç është transpozuar në ligjin kombëtar (Neni 11 (4) i Ligjit për Energjinë Elektrike), arritja e plotë e objektivës së Nenit 9 (1) të Direktivës së Energjisë Elektrike duhet të sigurohet nga autoriteti kombëtar rregullativ në mënyrë proaktive. Sekretariati shqyrtoi Vendimin Preliminar të ZRRE-së, përkundrejt atij sfondi.

#### 2. Zbatimi i dispozitave të shturjes së pronësisë në KOSTT

Gjatë vlerësimit të përputhshmërisë së Vendimit Preliminar me modelin e shturjes të përcaktuar në Direktivën e Energjisë Elektrike, aspektet e mëposhtme kanë rëndësi të veçantë:

- Ndërmarrja që do të certifikohet duhet të jetë pronari i aseteve të transmisionit, siç kërkohet nga Neni 9 (1) (a) i Direktivës së Energjisë Elektrike;
- Ndërmarrja që do të certifikohet duhet të kryejë funksionet dhe detyrat e një operatori të sistemit të transmisionit ashtu siç kërkohet nga Neni 9 (1) (a) i Direktivës së Energjisë Elektrike;
- Kontrolli dhe ushtrimi i të drejtave në ndërmarrjen që do të certifikohet duhet të ndahet nga kontrolli dhe ushtrimi i të drejtave në ndërmarrjet e përfshira në prodhimin ose furnizimin me energji elektrike dhe gaz natyror, siç kërkohet nga neni 9 (1) - (3), (7) dhe (12) të Direktivës së Energjisë Elektrike.

##### a. Pronësia e Sistemit të Transmisionit të Energjisë Elektrike

<sup>21</sup> Opinioni i Sekretariatit 1/16 i 3 Shkurtit 2016 TAP AG; Opinioni i Sekretariatit 1/17 i 23 janarit 2017 OST; Opinioni i Sekretariatit 3/17 të datës 23 janar 2017 EMS.

<sup>22</sup> Shih, për shembull, Opinioni e Komisionit për certifikimin e Vorarlberger Übertragungsnetze (VÜN) C (2012) 2244 final të 29.3.2012, në f. 4; për certifikimin e Augstsprieguma t`kls C (2012) 9108 final të 3.12.2012, në f. 2.

[Type text]

Neni 9 (1) (a) i Direktivës 2009/72/EC kërkon që "*çdo ndërmarrje që zotëron një sistem transmisioni vepron si një Operator i Sistemit të Transmisionit*". Kjo nënkupton në parim që ndërmarrja që aplikon për certifikim është pronar i asetëve, pra i sistemit të transmisionit. Në raste të jashtëzakonshme, Komisioni Evropian ka pranuar se në rastet kur OST nuk zotëron sistemin e transmisionit, të drejtat për menaxhimin e sistemit janë themeluar ndryshe.<sup>23</sup>

Në rastin aktual, nenet 26-27 të Ligjit nr. 05/L-081 për Energjinë përcaktojnë të drejtat e KOSTT-it mbi objektet e reja dhe ekzistuese të transmetimit të energjisë elektrike.<sup>24</sup>Neni 27 (4) i Ligjit për Energjinë përcakton që "*Të drejtat pronësore të përcaktuara me këtë nen, si dhe të drejtat pronësore mbi asetet e dhëna gjatë procesit të inkorporimit të një ndërmarrjeje energjetike që është licencuar në vitin 2006 për të operuar sistemin e shpërndarjes ose transmisionit të energjisë elektrike të Kosovës, duhet, menjëherë pas kërkesës së ndërmarrjes së energjisë, të regjistrohen në emër të ndërmarrjes së tillë të energjisë në Regjistrin përkatës të të drejtave mbi pronën e paluajtshme nga Zyra përkatëse Kadastrale Komunale.*" Neni 27 (2) i Ligjit për Energjinë i jep KOSTT-it të drejtën e servitutit 99 vjet për pronën në të cilën ndodhen objektet energjetike.

Asetet e transmetimit janë llogaritur në Raportin e Bilancit të KOSTT-it.<sup>25</sup>

Siç është thënë edhe në Opinionet e mëparshme<sup>26</sup>, Sekretariati konkludon se në një situatë të tillë si në rastin në fjalë, kur kuadri ligjor i një Pale kontraktuese jep një bazë ligjore të qartë si ajo e nenit 27 të Ligjit mbi Energjinë, kërkesa sipas nenit 9 (1) (a) të Direktivës 2009/72 / EC mund të konsiderohet e përbushur.

#### *Ndërmarrja aplikuese kryen detyra kryesore si Operator i Sistemit të Transmisionit*

Neni 9 (1) (a) i Direktivës së Energjisë Elektrike gjithashtu kërkon që ndërmarrja në fjalë "*të veprojë si operator i sistemit të transmisionit*". Nocioni i Operatorit të Sistemit të Transmisionit përcaktohet nga Neni 2 (4) i Direktivës së Energjisë Elektrike. Nga ky përkufizim rrjedh se elementet kryesore për një ndërmarrje që të konsiderohet si Operator i Sistemit të Transmisionit janë operimi, mirëmbajtja dhe zhvillimi i rrjetit të transmisionit<sup>27</sup>. Vlerësimi i një autoriteti rregullativ në këtë drejtim duhet të përcaktoj në veçanti nëse një ndërmarrje është me ligj duke kryer këto detyra kryesore dhe nëse disponon burimet e nevojshme (njerëzore, teknike, financiare) për këtë.<sup>28</sup>

Neni 16 (3) i Ligjit për Energjinë Elektrike kërkon që "*Operatori i Sistemit të Transmisionit të ketë të gjitha burimet e nevojshme njerëzore, teknike, fizike dhe financiare për funksionimin e sigurt, të besueshëm dhe afatgjatë të sistemit të transmisionit*". Neni 16 (1) i Ligjit për Energjinë Elektrike rendit detyrat e Operatorit të Sistemit të Transmisionit, duke përfshirë "*alokimin e kapaciteteve transmetuese ndërkufitare, në bashkëpunim me operatorët e sistemit të transmisionit nga palët e kontraktuara të Komunitetit të Energjisë*<sup>29</sup>, *menaxhimin e kongjestionit për të gjitha transaksionet në linjat e interkoneksionit me sistemet fqinje.*"

<sup>23</sup> Shih: Opinionin e Komisionit për certifikimin e REN Rede Electrica Nacional S.A. dhe REN Gasodutos S.A., C (2014) 3255 final, 12.05.2014 dhe Opinionin e Komisionit mbi certifikimin e Tranelectrica D.A., C (2015) 7053 final, 12.10.2015.

<sup>24</sup> Neni 26 i Ligjit për Energjinë.

<sup>25</sup> Aplikacioni i KOSTT për certifikim, paragrafi 27.

<sup>26</sup> Opinionin i Sekretariatit 3/17 i 23 janarit 2017 EMS.

<sup>27</sup> Opinionin i Sekretariatit 1/16 i 3 Shkurtit 2016 TAP AG.

<sup>28</sup> Opinionin e Komisionit për certifikimin e VÜN C (2012) 2244 final të datës 29.3.2012.

<sup>29</sup> Sipas nenit 16 (1.41) kjo e drejtë mund të transferohet në një entitet tjetër rajonal të themeluar për këtë qëllim (si p.sh. SEE CAO).

[Type text]

Sekretariati gjithashtu vë në pah konstatimet e ZRRE-së se "KOSTT gjithashtu ka treguar se për arsye jashtë kontrollit të tij nuk është në gjendje të kryej alokimin e kapaciteteve transmetuese të interkoneksionit"<sup>30</sup>. Ashtu siç ECRB vuri në pah në Opinionin e tij<sup>31</sup>, "Kapaciteti i KOSTT si Operator i Sistemit të Transmisionit nuk ndikohet nga fakti se nuk kryen aktivitetet dhe funksionet e kryera nga EMS, duke përfshirë [...] alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongestionit në interkoneksionet me vendet fqinje "<sup>32</sup>

Sekretariati pajtohet me konstatimet e ZRRE-së se KOSTT përmbush kriteret e posedimit të burimeve të nevojshme njerëzore, teknike, fizike dhe financiare për të kryer në mënyrë efektive detyrat e një Operatori të Sistemit të Transmisionit.

c. *Ndarja e kontrollit mbi transmision nga gjenerimi/furnizimi*

(c) Vendimi Preliminar vlerëson përputhjen e KOSTT-it me modelin e shthurjes së pronësisë sipas nenit 11 të Ligjit për Energjinë Elektrike, dispozitën që transpozon nenin 9 (6) të Direktivës së Energjisë Elektrike. Neni 9 (6) parasheh që dy organe të veçanta publike mund të shihen si dy persona të ndryshëm në kuptim të nenit 9 (1) dhe (2) të Direktivës 2009/72 / EC dhe mund të kontrollojnë aktivitetet e prodhimit dhe furnizimit, nga njëra anë , dhe aktivitetet e transmetimit nga ana tjetër. Nocioni i kontrollit përcaktohet më tej nga Rregullorja e Marxhes<sup>33</sup>dhe përfshin të drejtat e renditura në Nenin 9 (1) (b), (c) dhe (d) dhe (2) të Direktivës 2009/72 / EC, duke përfshirë ushtrimin e të drejtës së votimit, mbajtja e shumicës së aksioneve dhe kompetencat për të emëruar anëtarë të organeve të korporatave të OST dhe ata që përfaqësojnë ligjërisht OST-në<sup>34</sup>.

Ligji për Energjinë Elektrike, i vitit 2016, përjashton KOSTT-in nga zbatimi i dispozitave të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, veçanërisht ato që lidhen me kompetencën e emërimit të Bordit të Drejtorëve, ushtrimin të të drejtave të aksionarëve, kompensimit të Bordit të Drejtorëve dhe raportimit dhe emërimit të Komitetit të Auditimit. Në veçanti, Ligji për Energjinë Elektrike transferoi rolin e aksionarit të vetëm të KOSTT-it nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik tek Kuvendi i Kosovës \*. Ky ligj përcakton detyrimin e KOSTT-it për të raportuar mbi punën e tij para Kuvendit në baza vjetore dhe i jep kompetenca Kuvendit për emërimin dhe shkarkimin e Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it.

Sekretariati pajtohet me ZRRE-në se Kuvendi i Kosovës\* dhe Qeveria që përfaqësojnë aksionet e shtetit në KOSTT nga njëra anë dhe KEK/ HC Ujmani në anën tjetër, respektivisht në pajtim me Ligjin për Energjinë Elektrike, konsiderohen si organe publike brenda kuptimit të Nenit 9 (6) të Direktivës për Energjinë Elektrike.<sup>35</sup>

<sup>30</sup> ZRRE, Vendimi Preliminar, para. 75.

<sup>31</sup> Shih Opinionin e ECRB-së 01/19 KOSTT, par.36.

<sup>32</sup> Sekretariati, Kërkesa e arsyetuar në rastin ECS-3/08 të 13.05.2016, par. 69; ky vlerësim është konfirmuar me Vendimin 2016/02/MC-EnC dhe Vendimin 2018/12/MC-EnC të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë për Çështjen ECS-3/08 si dhe Opinionet përkatëse të Komitetit Këshillëdhënës.

<sup>33</sup> Rregullorja e Këshillit (EC) Nr. 139/2004, e datës 20 janar 2004, Gazeta Zyrtare L 24, 29.01.2004, f. 1-22 (Rregullorja mbi Kontrollin e Përqëndrimit të Ndërmarrjeve Publike).

<sup>34</sup> Neni 9 (2) i Direktivës 2009/72 / EC dhe Neni 54 (4) i Ligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike.

<sup>35</sup> Shih për shembull: Opinionin i Komisionit për Certifikimin e Energinet (gazit) (C (2012) 88, 9.01.2012;Opinionin mbi certifikimin e VÜN (energji elektrike) të VÜN C (2012) 2244 final të datës 29.3.2012; (C (2012) 6258, 06.09.2012; Opinionin i Komisionit mbi Certifikimin e GTS të (C (2013) (C (2012) 3011, 30.04.2012; Opinionin i Komisionit për certifikimin e Affärsverket svenska kraftnät ) 4205, 01.07.2013; Opinionin i Komisionit për certifikimin e Litgridit (C (2013) 4247, 04.07.2013.

[Type text]

Nisur nga kjo, për të arritur plotësisht objektivën e Nenit 9 të Direktivës së Energjisë Elektrike - parandalimin e konflikteve potenciale dhe ekzistuese të interesit - dhe për të siguruar shthurjen e ndërmarrjeve të kontrolluara nga organet publike në mënyrë të barabartë me ndërmarrjet private, Neni 9 (6) i Direktivës së Energjisë Elektrike nuk mund të interpretohet formalisht. Ndarja e kontrollit ndërmjet dy organeve publike në fjalë duhet të jetë efektive në kuptimin që siguron pavarësinë e plotë të organit publik që kontrollon Operatorin e Sistemit të Transmisionit nga çdo njësi tjetër që kontrollon aktivitetet e prodhimit dhe furnizimit.

### 1. Operatori i Sistemit të Transmisionit nuk është i përfshirë në aktivitetet e gjenerimit/furnizimit

Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe organi kompetent publik ose privat që e kontrollon atë, në parim nuk mund të angazhohet në aktivitetet e prodhimit dhe furnizimit të energjisë elektrike. Në këtë drejtim, Sekretariati vëren se KOSTT ka dy licenca - për operimin e sistemit të transmisionit dhe për operimin e tregut. Ka vetëm ndarje të llogarive ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Operatorit të Tregut<sup>36</sup>. Si operator i tregut, KOSTT blen energjinë nga impiantet energjetike që përfitojnë nga mbështetja për promovimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe blen dhe shet energjinë e nevojshme për qëllime balancimi. KOSTT gjithashtu ka shprehur interes në pjesëmarrjen si aksionar në themelimin e një shkëmbimi të energjisë së bashku me OST-në e Shqipërisë. Në këtë drejtim janë nënshkruar dy Memorandume të Mirëkuptimit, një nga ministritë përkatëse nga Shqipëria dhe Kosova\* më 28 nëntor 2017, dhe një tjetër midis autoriteteve kombëtare rregullative dhe OST-ve nga Shqipëria dhe Kosova\* më 17 gusht 2018.

Sekretariati pajtohet me ZRRE-në dhe nuk merr në konsideratë funksionet e KOSTT-it në lidhje me blerjen e energjisë elektrike për qëllime të balancimit ose nga burimet e ripërtëritshme, ose pjesëmarrjen e tij në një shkëmbim të ardhshëm ndërkufitar të energjisë, për të ngritur ndonjë shqetësim. Sekretariati konsideron se nuk ekziston rreziku i diskriminimit nga KOSTT ndaj gjeneratorëve të tjerë, për sa kohë që Operatori i Tregut vepron vetëm si blerës i centralizuar i energjisë së prodhuar nga burimet e ripërtëritshme përderisa ato janë brenda një kornize të rregulluar të tarifës nxitëse dhe kanë kapacitet të vogël<sup>37</sup>. Në mënyrë të ngjashme, duke u bazuar në praktikën e Komisionit Evropian, meqë shkëmbimet e energjisë funksionojnë si platforma që lehtësojnë tregtinë e energjisë elektrike dhe gazit duke iu përshtatur ofertës dhe kërkesës në tregjet përkatëse dhe nuk janë vetë të angazhuar në blerjen ose shitjen e energjisë elektrike, nëse KOSTT mban aksione në ndonjë shkëmbim të ardhshëm të energjisë nuk do të përfaqësonte një pengesë për certifikim sipas modelit të shthurjes së pronësisë.<sup>38</sup>

Së fundmi, KOSTT është gjithashtu një nga themeluesit e Zyrës së Ankandit Koordinues të Evropës Juglindore (SEE CAO) në Podgoricë dhe zotëron 12.5% të aksioneve të saj. Siç ka theksuar Sekretariati edhe në Opinionet e mëparshme<sup>39</sup>, kompania nuk është e angazhuar në aktivitetet e prodhimit dhe furnizimit ose të energjisë elektrike apo gazit dhe prandaj pjesëmarrja e KOSTT në të nuk shkakton shqetësime në lidhje me konfliktin e interesit.

<sup>36</sup> Aplikacioni i KOSTT, paragrafi 19.

<sup>37</sup> Opinioni i Komisionit, certifikimi i Societa Gasdotti Italia S.p.A., C (2013) 380 përfundimtar, 23.01.2013.

<sup>38</sup> Opinioni i Komisionit për certifikimin e Energjet (gazit) (C (2012) 88, 09.01.2013 f.3

<sup>39</sup> Opinioni i Sekretariatit 1/18 i 27 shkurtit 2018 CGES.

[Type text]

Bazuar në këtë, Sekretariati pajtohet me ZRRE-në se aplikuesi KOSTT nuk është i angazhuar në aktivitetet e prodhimit apo të furnizimit.

## 2. Ndarja dhe pavarësia e organeve publike

Me qëllim të përcaktimit se dy organet publike të ngarkuara për të ushtruar kontroll mbi ndërmarrjet në pronësi të shtetit janë të pavarur nga njëri-tjetri dhe nuk ka ndikim të përbashkët të një entiteti të tretë publik ose privat, organi publik i cili kontrollon Operatorin e Sistemit të Transmisionit duhet të ketë kompetenca të përcaktuara qartë dhe të përshkruara, duhet të kryejë detyrat që i janë dhënë nga Komuniteti i Energjisë dhe ligji kombëtar në një autonomi të plotë dhe nuk mund të jetë në varësi të subjekteve publike ose private që kontrollojnë ndërmarrjet e prodhimit ose furnizimit të energjisë.<sup>40</sup>

Ligji për Energjinë Elektrike përcakton Kuvendin e Kosovës\* si organ publik që ushtron të drejtat e aksionerëve mbi KOSTT. Në Asamblenë e Përgjithshme të KOSTT-it, Kuvendi i Kosovës\* përfaqësohet nga një përfaqësues i emëruar nga Kryetari i Kuvendit. Nga ana tjetër, Qeveria përfaqësohet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik në Kuvendin e Përgjithshëm të KEK-ut dhe HC Ujmanit.

ZRRE-ja në Vendimin e saj Preliminar thekson se Kushtetuta bazohet në parimin e ndarjes së kompetencave ndërmjet organit legjislativ jo-ekzekutiv (Kuvendi), organit ekzekutiv të zbatimit të ligjit (Qeverisë) dhe Presidentit të Kosovës\*. ZRRE konstaton se "KOSTT ka deklaruar në kërkesën e tij se transferimi i të drejtave të aksionarëve mbi KOSTT-in nga Ministria (Qeveria) në Kuvend ka siguruar masa të mjaftueshme mbrojtëse për të siguruar që kontrolli mbi OST ushtrohet pa ndikim nga organi publik që kontrollon interesat e Shtetit mbi gjenerimin (prodhimin), përkatësisht nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik e Qeverisë. "

Sekretariati pajtohet me konstatimet e ZRRE-së se në përgjithësi, Kuvendi, përkatësisht Parlamenti i Kosovës dhe Qeveria e Kosovës\* kanë kompetencat dhe mjetet e nevojshme për të ushtruar kontroll mbi KOSTT-in nga njëra anë dhe KEK / HC Ujmani në anën tjetër, respektivisht në mënyrë ligjore dhe faktike të pavarur.

Sekretariati pajtohet që dy organet relevante publike, Kuvendi dhe Qeveria, janë të pavarura në drejtim të emërimit të anëtarëve të organeve korporative të kompanive të tyre përkatëse siç kërkohet nga Neni 9 (1) (c) i Direktivës së Energjisë Elektrike. Procedura për emërimin e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të KOSTT përcaktohet nga neni 14 i Ligjit për Energji Elektrike, i cili përcakton se procedura udhëhiqet nga Ministria e Administratës Publike, e cila në rast të një pozite të lire në Bordin e Drejtorëve bën një shpallje publike. Komisioni Parlamentar për Energjinë, pas pranimit të dosjeve të aplikuesve, i paraqet Kuvendit së paku dy kandidatë për secilën pozitë të hapur. Kuvendi me shumicën e votave emëron një nga kandidatët e rekomanduar.

Sa i përket emërimit të organeve drejtuese të KOSTT-it, ZRRE thotë se Neni 62 (9) i Ligjit për Energji Elektrike lejon "Anëtarët e Bordit aktual të OST-së, përfshirë Kryesuesin dhe Komisionin e Auditimit [të] vazhdojnë të kryejnë funksionet e tyre deri në përfundim të mandatit të tyre". Gjatë shkëmbimit të

<sup>40</sup> Shih për krahasim, Opinioni i Komisionit mbi Certifikimin e Slovenská elektrizačná prenosová sústava a.a., C (2013) 5376 final, 9.08.2013; Opinioni i Komisionit për Certifikimin e Polskie Sieci Elektroenergetyczne S.A. C (2014) 2471 final, 09.04.2014; Opinioni i Komisionit për certifikimin e GAZ-SYSTEM S.A., C (2014) 5457 final, 25.07.2014; Opinioni i Komisionit për certifikimin Magyar Gáz Tranzit Zrt., C (2015) 1046 final, 17.02.2015.



[Type text]

informatave me Sekretariatit, ZRRE konfirmoi se mandati i anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të KOSTT<sup>41</sup> dhe mandati i Komitetit të Auditimit<sup>42</sup> ka skaduar dhe se emërimi i anëtarëve të rinj të Bordit e Drejtorëve dhe Komitetit të Auditimit është në proces seleksionimi nga Kuvendi i Kosovës \*. Sekretariati fton ZRRE-në që të monitorojë procesin e emërimit dhe të sigurojë që i njëjti person nuk është anëtar i Bordit të ndonjë Gjeneratori dhe një OST-je, siç kërkohet nga Neni 9 (1) (d) i Direktivës së Energjisë Elektrike.

KOSTT shpjegoi se aksionari ka të drejtë të kërkojnë dividendë, dhe se në të kaluarën, kur Qeveria ishte aksionare e KOSTT-it, ajo kishte përfituar nga kjo e drejtë<sup>43</sup>. ZRRE në anën tjetër nuk ka vlerësuar se si dhe kujt i janë paguar dividendët nga KOSTT dhe nga ndërmarrjet e tjera publike energjetike aktive në gjenerim, KEK/ HC Ujmani. Kjo pyetje është e rëndësishme për të përcaktuar se cili entitet brenda Kosovës \* ka një interes financiar në ndërmarrjet publike të energjisë dhe të verifikoj nëse dividendët nga KOSTT por edhe nga KEK/HC Ujmani shkojnë në buxhetin e shtetit, pavarësisht nëse aksionerët e ndryshëm janë të pavarur në vendosjen e përdorimit të atyre dividendëve.

Së fundi, ZRRE-ja nuk elaboron kompetencat e Qeverisë, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik në lidhje me KOSTT-in edhe pse të gjitha ato organe publike mbajnë kompetenca, në kuptim të informatave që marrin nga KOSTT edhe pas transferimit të të drejtave të aksionarëve në Kuvend.

Sa i përket Qeverisë, neni 13 (7) i Ligjit për Energjinë Elektrike kërkon që Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it të informojë Qeverinë "me qëllim të monitorimit të zbatimit të politikave në sektorin e energjisë". Për më tepër, Qeveria hyn në marrëveshje të huasë financiare ndërkombëtare për zhvillimin e infrastrukturës së KOSTT-it, si një huamarrës kryesor<sup>44</sup>. Sekretariati merr parasysh Nenin 13 (7) të Ligjit për Energjinë Elektrike, në bazë të të cilit Qeveria duhet të mbahet e informuar me qëllim të zbatimit të politikave të saj, të një natyre të përgjithshme dhe jo një përfshirje specifike në aktivitetet dhe detyrat e Operatorit të Sistemit të Transmisionit. Megjithatë, meqenëse ky artikull është i natyrës së përgjithshme dhe nuk përcakton se çfarë lloj informacioni kërkohet nga KOSTT, Sekretariati fton ZRRE-në që të përpunojë këtë aspekt në Vendimin Përfundimtar me qëllim që të largojë çdo konflikt potencial interesi në lidhje me informatat konfidenciale që ofrohen nga KOSTT tek ndonjë organ publik, përveç aksionarit të tij. Sa i përket Qeverisë si huamarrës kryesor, ose garantues, pjesëmarrës në marrëveshjet e huasë të kryera nga KOSTT për projekte infrastrukturore, kjo vetëm do të ngriste shqetësime në rastin kur Qeveria ka fjalën vendimtare në atë se a do të zhvillohet apo jo ndonjë projekt i tillë infrastrukturor, përkatësisht, në rastet kur Qeveria mund të vendosë selektivisht të mbështesë vetëm huatë që do të ishin të dobishme për zhvillimin e infrastrukturës së transmetimit, vetëm në fushat nga të cilat KEK-u do të përfitonte.

Sa i përket Ministrisë së Financave, sipas aplikacionit të KOSTT-it për Certifikim<sup>45</sup>, Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë obligon OST-në të njoftojë me shkrim Ministrinë e Financave për "ngjarje të rëndësishme" lidhur me "a) formimin ose pjesëmarrjen në formimin e një subjekti juridik, të shoqërisë, të partneritetit, të besimit, sipërmarrjes së përbashkët të papërfshirë ose ndonjë marrëveshjeje të ngjashme, ose ndonjë organizate apo shoqate tjetër afariste ose jo-afariste; b) blerjen, disponueshmërinë ose modifikimin e dukshëm të natyrës ose shtrirjes së ndonjë interesi të mbajtur në ndonjë organizatë ose shoqatë të përmendur në pikën (a) më sipër; c) blerjen ose asgjësimin e ndonjë aktivi

<sup>41</sup> Vendimi i Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it, Nr.07 / 47, të datës 02.09.2015, emëroi anëtarët e Bordit për tre vjet.

<sup>42</sup> Vendimi i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik për emërimin e Komitetit të Auditimit të KOSTT-it, Nr. 2402, datë 09.10.2015.

<sup>43</sup> Aplikacioni i KOSTT-it, par.151.

<sup>44</sup> Aplikacioni i KOSTT-it, par. 161.

<sup>45</sup> Aplikacioni i KOSTT-it, par. 74.

[Type text]

*operacional ose të ndonjë aktivi tjetër të rëndësishëm; d) ndërprerjen, zgjerimin ose modifikimin e veprimtarisë së tij; e) ushtrimin e interesit të tij pronësor në çdo organizatë ose shoqatë të përmendur në pikën f) më lartë për të bërë që organizata ose shoqata e tillë të ndërmarr ndonjë veprim të përcaktuar në pikat (a) - (d) më sipër; dhe g) angazhimi në ndonjë aktivitet huamarrës ose huadhënës.<sup>46</sup>*

Raporti i bazuar në nenin 56 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë është i detyrueshëm për të gjitha ndërmarrjet publike (KOSTT por edhe KEK/HC Ujmani) dhe duhet të hartohet në përputhje me rregullat e zhvilluara nga Drejtori Qendrorë e Hamonizimit të Menaxhimit Financiar e Ministrisë së Financave.<sup>47</sup> Pas marrjes së një propozimi nga ndërmarrja publike (për shembull, krijimin e një partneriteti publiko-privat sipas nenit 56 (a)), Ministri i Financave ka 15 ditë "të refuzoj ose të miratoj" kërkesën me shkrim, ose të vendosen kushte për atë miratim<sup>48</sup>. Në fund, Qeveria duhet ta ratifikojë vendimin në mënyrë që të jetë efektiv.

Fakti që një vendim për ngjarje të rëndësishme, siç renditet në Nenin 56 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, varet nga miratimi i Ministrisë së Financave dhe konfirmimi nga Qeveria mund të cenoj të drejtën e Kuvendit si organ publik që kontrollon OST-në për të kryer detyrat e tij në një autonomi të plotë. Për më tepër, raportet e tilla janë dorëzuar dhe kërkohet miratimi nga Ministria e Financave edhe për veprime të ngjashme të KEK /HC Ujmani. Meqenëse Ministria e Financave, duke qenë pjesë e një organi kolektiv (Qeveria) që kontrollon aktivitetet e gjenerimit, do të ketë të drejtë të miratoj ose të refuzoj vendimet e KOSTT lidhur me ngjarjet e rëndësishme, kjo mund të çojë në vendimmarrje selektive në favor të gjenerimit publik . Duke pasur parasysh këto shqetësime, Sekretariati fton ZRRE-në që të hetojë shembuj konkretë të raportimit të tillë dhe të vlerësojë ndikimin e Ministrisë së Financave mbi vendimmarrjen e pavarur të KOSTT dhe aksionarit të saj, Kuvendit të Kosovës\* dhe nëse është e nevojshme kushtëzojnë certifikimin e KOSTT-it me ndryshimet në kornizën legjislative.

Sa i përket Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, ZRRE vë në dukje se në kuadër të MZHE-së u krijua një njësi e dedikuar me qëllim të monitorimit të performancës së të gjitha ndërmarrjeve publike dhe që kompetencat dhe funksionet e kësaj njësie janë përcaktuar me Ligjin për Ndërmarrjet Publike. Ministria, dhe Njësia e saj për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike, bazuar në Nenin 30 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, ende është e autorizuar të marrë planin vjetor të biznesit të përgatitur nga KOSTT, i cili përfshin ndër të tjera:

- Një përshkrim të objektivave biznesore dhe financiare që duhet të arrihen nga ndërmarrjet publike dhe afatet kohore për zbatim;
- Mënyrat e zgjedhura për arritjen e këtyre objektivave;
- Përcaktimi i kostos totale të operacioneve dhe mënyra me të cilën do të financohet kjo kosto;
- Veprimet specifike që duhet të ndërmerren për të arritur objektivat e përcaktuara; dhe
- Detyrimet e ndërmarrjeve publike në raport me konsumatorët dhe publikun.

Në bazë të këtij neni, Ministria e Zhvillimit Ekonomik merr planet e biznesit me investimet e planifikuara të të gjitha ndërmarrjeve publike, KOSTT dhe KEK / HC Ujmani, pasi një aktivitet i tillë bazohet në të drejtat e mëparshme të Qeverisë në aksione tek të gjitha ndërmarrjet publike energjetike. Në varësi të ndjeshmërisë së informacionit, kompetencat e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, e cila në emër të Qeverisë ushtron të

<sup>46</sup> Neni 56 i Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

<sup>47</sup> Neni 6 (3) i Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

<sup>48</sup> Neni 54 i Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

[Type text]

drejtat e aksionerëve në ndërmarrjet energjetike aktive në gjenerimin e energjisë elektrike, lidhur me marrjen e informacionit për planifikimin e rrjetit nga KOSTT mund të jenë në konflikt me autonominë e KOSTT në planifikimin financiar dhe atë investiv.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Energji Elektrike, KOSTT-i informoi Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik për ndryshimin e të drejtave të aksionerëve nga Ministria tek Kuvendi, gjë që do të ndikonte edhe në detyrimet raportuese ndaj Njesisë për Politika dhe Monitorim dhe kërkoi takim për të diskutuar marrëveshjet e ardhshme të bashkëpunimit<sup>49</sup>. Ndërkohë që letra që KOSTT i ka dërguar Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik në lidhje me raportimin ndaj saj si tek një aksioner është për t'u mirëpritur. Neni 30 i Ligjit për Ndërmarrjet Publike që kërkon paraqitjen e planit të biznesit përcakton kompetencat që mund të ndikojnë në autonominë e OST-së lidhur me ushtrimin e njërit prej funksioneve kryesore që i janë dhënë nga ligji i Komunitetit të Energjisë, që është planifikimi i rrjetit<sup>50</sup>. Prandaj, Sekretariati është i shqetësuar se Ministria e Zhvillimit Ekonomik mund të tregoj anshmëri, nisur nga kontrolli i saj mbi KEK-un dhe HC Ujmanin dhe mund të përdorë informacionin e marrë nga KOSTT, që do të rezultonte në efekte negative në zhvillimin e rrjetit por në dobi të gjenerimit të tij<sup>51</sup>. Një miratim direkt ose një e drejtë e përvokueshme e vetos për investimet e planifikuara për KOSTT-in nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik nuk është në përputhje me Nenin 9 (1) dhe (2) të Direktivës.<sup>52</sup> Sekretariati fton ZRRE-në të vlerësoj kompetencat e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, në pajtim me Nenin 30 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe nëse është e nevojshme të kushtëzojë certifikimin e KOSTT-it me heqjen e këtyre të drejtave. Vlerësimi i ZRRE-së në lidhje me informatat që Qeveria dhe dy ministritë pranojnë dhe miratimin e tyre ose të drejtën e përvokueshme të vetos, duhet të bëhet kundrejt kërkesave që *"një person i cili ka interes në prodhimin dhe furnizimin [e gazit] në të njëjtën kohë ka fjalën vendimtare në atë nëse investimet e rëndësishme në infrastrukturën e transmetimit [të gazit] mund të shkojnë përpara apo jo, nxitja e abuzimit të kontrollit mbi investimet në OST me qëllim të favorizimit të interesave të gjenerimit ose furnizimit, përkatësisht duke mbajtur konkurrentët e mundshëm jashtë tregut dhe duke parandaluar që investimet të ndodhin."*<sup>53</sup>

Lidhur me marrëdhëniet ndërmjet tri organeve publike (Qeveria, Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Ministria e Financave) në fushat e adresuara më sipër, ZRRE-së i kërkohet të vlerësojë çështjet e pajtueshmërisë në Vendimin e saj Përfundimtar dhe, nëse është e nevojshme, të kushtëzojë Certifikimin e KOSTT-it me bartjen e plotë të detyrave që lidhen me OST-në tek aksionari i tij i vetëm, Kuvendi i Kosovës\*. Nëse një proces i tillë kërkon ndryshime të legjislacionit primar dhe sekondar, mund të ofrohet një periudhë e arsyeshme kalimtare.

### 3. Qeverisja e OST-së për të lejuar pavarësinë e plotë në vendimmarrjen e përditshme

Fakti që dy organet publike në fjalë mbeten pjesë e së njëjtës ndërmarrje të integruar vertikalisht, shteti, mund të kërkojë futjen e masave mbrojtëse shtesë brenda organizimit të Operatorit të Sistemit të Transmisionit për të siguruar pavarësinë e tij të plotë në vendimmarrjen e përditshme. Kur një nga dy organet publike në fjalë ushtron funksione të krijimit të politikave që në fakt mund të ndikojnë në

<sup>49</sup> Aplikacioni i KOSTT-it, par. 76.

<sup>50</sup> Shih: Opinioni i Komisionit mbi Certifikimin e Shërbimeve të Transportit të Gazit B.V. C (2013) 4205 final, 01.07.2013; Opinioni i Komisionit për certifikimin e Amber Grid, C (2015) 2135 final, 23.03.2015; Opinioni i Komisionit mbi certifikimin e TenneT TSO.B.V., C (2016) 3987, 22.06.2016.

<sup>51</sup> Opinioni i Komisionit mbi certifikimin e Shërbimeve të Transportit të Gazit B.V. C (2013) 4205 final, 01.07.2013.

<sup>52</sup> Opinioni i Komisionit mbi certifikimin e TenneT TSO.B.V., C (2016) 3987, 22.06.2016.

<sup>53</sup> Opinioni i Komisionit për certifikimin e Shërbimeve të Transportit të Gazit B.V. C (2013) 4205 final i datës 1.7.2013 për certifikimin e TenneT. C (2013) 4206 final i datës 1.7.2013.

[Type text]

vendimmarrjen e Operatorit të Sistemit të Transmisionit, pavarësia e plotë mund të kërkojë gjithashtu futjen e masave shtesë organizative brenda organit publik në fjalë.

Neni 9 (6) i Direktivës së Energjisë Elektrike nuk kërkon vetëm ndryshime strukturore ndërmjet organeve publike të përfshira në sektorin e energjisë, por edhe brenda vetë OST-së dhe brenda organeve të veçanta publike deri në masën që kjo kërkohej me arritjen e objektivit të shturjes së pronësisë, parandalimin e konflikteve potenciale dhe aktuale të interesit. Ndonëse ndarja formale e kompetencave në nivelin e qeverisë përbën një kusht të rëndësishëm për shturjen e një OST-je në pronësi shtetërore, pavarësia e plotë e operimit të rrjetit nga interesat e furnizimit dhe gjenerimit kërkon gjithashtu masa lidhur me, ndër të tjera, eliminimin e shkëmbimeve të çdo informate konfidenciale në baza ditore.<sup>54</sup> Duke qenë se sipas Nenit 9 (6) të Direktivës së Energjisë Elektrike, OST vazhdon të operoj brenda Shtetit sikur të ishte një ndërmarrje e integruar vertikalisht, kjo është me rëndësi të veçantë. Prandaj, shteti duhet të ketë masa efektive për të parandaluar bashkërendimin e panevojshëm, sjelljen diskriminuese dhe shpërndarjen e panevojshme të informatave konfidenciale, duke përfshirë edhe nivelin e stafit mbështetës dhe administratës.<sup>55</sup> Deri në ç'masë kjo kërkon masa më të detajuara të kufizimeve dhe rritje të mbikëqyrjes rregullative, mbetet të vlerësohet rast pas rasti.

Në rastin e Kosovës\*, dy organet publike që kontrollojnë OST-në dhe aktivitetet gjeneruese janë Kuvendi dhe Qeveria, dhe në Kushtetutë sigurohet ndarja mes tyre dhe pavarësia e tyre nga njëra-tjetra, si dhe nga organet e treta publike. Megjithatë, Sekretariati konsideron se masat mbrojtëse për sigurimin e pavarësisë menaxheriale gjatë operacioneve të përditshme, si dhe për pavarësinë financiare dhe operacionale të OST-së mund të përmirësohen ende brenda vetë OST-së. KOSTT raportoi për disa nga këto masa tashmë të vendosura si: kodin e etikës, një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë drejtorët e Bordit, si dhe një kod të veçantë etike të detyrueshëm për të gjithë personelin e ndërmarrjes.<sup>56</sup> Masat e tjera kanë të bëjnë me ndalimin e shpërndarjes së informative konfidenciale. ZRRE është ftuar që të vlerësojë më tej pavarësinë e OST-së lidhur me punën e përditshme, në Vendimin Përfundimtar. Në veçanti, duhet të fokusohet në elaborimin e zbatimit të dispozitave ligjore të referuara nga KOSTT. Pasi që disa prej këtyre rregullave janë vendosur përpara shturjes pronësore të KOSTT-it, ZRRE duhet të verifikojë nëse rregullat e vendosura të janë të kënaqshme në zbatim, sipas kërkesave për shturjen e pronësisë.

Modeli i shturjes së pronësisë ka për qëllim të sigurojë një situatë në të cilën diskriminimi mund të përjashtohet në bazë të strukturës së pronësisë së OST-së. Në rastet sipas nenit 9 (6) të Direktivës së Energjisë Elektrike, ku kontrolli mbetet brenda strukturave të shtetit, mund të kërkohej masat mbrojtëse për të siguruar funksionimin e pavarur të rrjetit. Në Opionet e mëparshme, Sekretariati ka kërkuar zbatimin e një Programi të Pajtuëshmërisë dhe emërimin e një zyrtari të pajtuëshmërisë. KOSTT në kërkesën e tij për certifikim iu referua Ligjit për Energjinë Elektrike të vitit 2004, i cili në atë kohë, me qëllim të sigurimit të pavarësisë, i kërkonte OST-së të krijonte një program pajtuëshmërie. Megjithatë, pasi që Ligji i Energjisë Elektrike i vitit 2016 nuk përmban një kërkesë të tillë, asnjë zyrtar i pajtuëshmërisë nuk është caktuar dhe asnjë program pajtuëshmërie nuk është në fuqi në KOSTT. Prandaj, Sekretariati e konsideron të dobishme përtej masave në fuqi, që t'i KOSTT-it të zbatoj një program pajtuëshmërie dhe të emëroj një zyrtar të pajtuëshmërisë. Zyrtari i pajtuëshmërisë dhe programi i pajtuëshmërisë duhet të zhvillohen sipas kërkesave të nenit 21 të Direktivës së Energjisë Elektrike dhe duhet të përfshijnë të drejta të gjëra lidhur me vendimet

<sup>54</sup> Paragrafi 15 i Direktivës së Energjisë Elektrike.

<sup>55</sup> Shih, për krahasim, Opinionin e Komisionit për certifikimin e Energinet (gazit) (C (2012) 88, 9.01.2012; Opinionet mbi certifikimin e Vorarlberger Übertragungsnetze (VÜN) C (2012) 2244 final i 29.3.2012.

<sup>56</sup> Aplikacionet e KOSTT-it, par. 112-113.

[Type text]

për investime. Në veçanti, duhet të raportojnë në ZRRE dhe të publikojnë në faqen e internetit një raport mbi marrëdhëniet ndërmjet KOSTT-it dhe organeve publike që kontrollojnë KEK/ HC Ujmani lidhur me shkëmbimin e informacionit dhe kërkesat e raportimit siç është elaboruar në seksionin e mësipërm.

#### IV. Përfundimet

Përkundër këtyre, Sekretariati mbështet certifikimin e KOSTT-it në përputhje me Vendimin Preliminar të ZRRE-së, subjekt i vërejtjeve vijuese. Sekretariati kërkon që ZRRE-ja më tej të vlerësojë dhe përpunojë:

- a) procesin e emërimit të anëtarëve në Bordin e Drejtorëve të KOSTT-it nga Kuvendi dhe për të siguruar që i njëjti person nuk është anëtar i bordit të një gjeneratori dhe një OST-je, siç kërkohet nga Neni 9 (1) (d) i Direktivës së Energjisë Elektrike
- b) Marrëdhëniet ndërmjet KOSTT-it dhe Qeverisë, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Ministrisë së Financave (të tilla si shkëmbimi i informacionit, raportimi dhe vendimmarrja në lidhje me asetet e transmisionit).

Në masën që vlerësimi sipas b) shpie në shqetësime në mënyrën e përshkruar më lartë, ZRRE-së kërkohet që në Vendimin e saj Përfundimtar të kërkojë transferimin e plotë të detyrave nga Qeveria, Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Ministria e Financave në lidhje me KOSTT në një organ apo institucion të pavarur, si vetë ZRRE-ja ose Kuvendi i Kosovës \*.

ZRRE gjithashtu ftohet të kërkojë zbatimin e një programi pajtueshmërie dhe emërimin e një zyrtari të pajtueshmërisë, dhe të sigurohet që të raportojnë për marrëdhëniet ndërmjet dy organeve publike që kontrollojnë KOSTT dhe KEK/ HC Ujmani.

Sipas Nenit 3 të Rregullores së Energjisë Elektrike, ZRRE-ja do të marrë parasysh maksimalisht komentet e mësipërme të Sekretariatit kur të marrë vendimin e saj përfundimtar lidhur me Certifikimin e KOSTT-it. ZRRE gjithashtu do të komunikojë vendimin e saj përfundimtar tek Sekretariati dhe do të publikojë vendimin e saj së bashku me Opinionin e Sekretariatit.

Sekretariati do ta publikojë këtë Opinion në faqen e vet të internetit. Sekretariati nuk i konsideron kofidenciale informatat që përmban ky Opinion. ZRRE ftohet të informojë Sekretariatin brenda pesë ditëve të punës pas marrjes nëse dhe përse konsideron se ky dokument përmban informacione kofidenciale të cilat ajo dëshiron të fshihen përpara publikimit të tillë.

[Type text]

Vienë, 1 Shkurt 2019



Janez Kopač

Drejtore



Dirk Buschle

Zëvendës Drejtore/Këshilltare Ligjore

[Type text]



**Energy Community Secretariat**  
Am Hof 4, Level 5, 1010 Vienna, Austria

<b>Phone</b>	+43 (0)1 535 2222
<b>Email</b>	<a href="mailto:contact@energy-community.org">contact@energy-community.org</a>
<b>Web</b>	<a href="http://www.energy-community.org">www.energy-community.org</a>